RAPORT 2 MUJOR I PLATFORMËS SHQIPËRIA QË DUAM'

6 TETOR – 6 DHJETOR 2017

RAPORT MUJOR
PLATFORMA 'SHQIPËRIA QË DUAM'
Nëntor 2017

Për të gjithë Ju!

RAPORTI 2 MUJOR I ZYRËS SË BASHKËQEVERISJES

Siç do ta shihni më poshtë, bashkëqeverisja jonë me njerëzit e zakonshëm nuk është slogan, po një praktikë e re bashkëveprimi mes qytetarëve dhe qeverisë, e cila qysh në hapin e parë dëshmon vlerën po edhe potencialin e saj të jashtëzakonshëm.

Apeli ynë për të gjithë, pa dallim bindjesh e përkatësish politike, është: Regjistrohuni në koalicionin e madh bashkëqeverisës përmes platformës **www.shqiperiaqeduam.al** dhe me një mesazh të drejtëpërdrejtë, çdo ministër vihet në dispozicionin Tuaj. Kështu Ju mund të zgjidhni problemin Tuaj apo përcillni fjalën Tuaj deri në qeveri dhe njëkohësisht të ndikoni që qeverisja të bëjë më shumë e më mirë, për Shqipërinë që duam me shtet - punë - mirëqenie.

ANKESA IME (nivel qendror)



ANKESA IME (nivel vendor)



Nisma ime


Nisma ime
80
70
60
50
40
30
20
10
0
6
5
10
2
0
9
4
0
2
0
0
0
0
0
0
71
2
9
11
1
0
4
0
0
0
0
0
0
Total në proces
Total të përfunduara
Kryeministria
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Ministria e Brendshme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Kulturës
-Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministria e Shtetit për Diasporën

Fjala ime


Fjala ime
70
60
50
40
30
20
10
0
6
4
0
2
5
0
1
0
0
0
0
0
0
0
0
58
18
10
0
3
0
0
0
0
0
0
0
0
Total në proces
Total të përfunduara
Kryeministria
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Brendshme
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Kulturës
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministria e Shtetit për Diasporën

Rubrika të tjera

INTERPELANCA IME

- Nuk ka asnjë kërkesë për interpelancë të depozituar gjatë kësaj periudhe.

SHKOLLA IME

- Nuk ka asnjë hyrje të depozituar në rubrikën 'Shkolla Ime' gjatë kësaj periudhe.

KUVENDIMI YNË

Në total janë depozituar **12** mendime në lidhje me projektbuxhetin e 2018:

- 5 propozime janë për shtimin e investimeve në sektorin e bujqësisë;
- 1 propozim është për rritjen e shpenzimeve në fushën e mbrojtjes;
- 1 propozim është për investimet në infrastrukturën e rrugëve dhe hekurudhave;
- 1 propozim është për rritjen e pensioneve dhe ndihmave për personat me aftësi të kufizuar;
- 1 propozim është për rritjen e numrit të të punësuarve;
- 1 propozim është për më shumë investime në fushën e shëndetësisë;
- 1 propozim është për më shumë investime në fushën e arsimit;
- 1 propozim është për më shumë investime në përmirësimin e kushteve të mjedisit.

Biznesi im


20
18
16
14
12
10
8
6
4
2
0
18
14
1
Total në proces
Total të përfunduara

Dua të kontribuoj



HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E DREJTËSISË**

Emri i Qytetarit: Olian Muska

Nr. i çështjes: 2860

Qytetari ju drejtua platformës më datë 14.11.2017 dhe mori zgjidhje me datë 21.11.2017.

Problemi: Qytetari kishte bërë deklarim për legalizim që në vitin 2006. Sipas ALUIZNI-t Pogradec dokumentacioni ishte i plotë dhe i saktë. Më pas qytetari ishte paraqitur pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t në Korçë për të përfunduar procesin, por aty procesi nuk kishte marrë përgjigje për më shumë se 1 vit.
Zgjidhja: Pas kontaktimit nga ana jonë me zyrën përkatëse dhe shqyrtimit të dosjes së qytetarit, u arrit në konkluzionin që dosja e tij ishte kthyer në zyrën e Pogradecit, pasi dosja kishte disa mangësi. Në vijim të adresimit të shpejtuar të problemit dhe pas plotësimit të anës ligjore, qytetari mori lejen e legalizimit nga Drejtoria e Korçës.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E DREJTËSISË**

Emri i Qytetarit: Enerida Mema

Nr. i çështjes: 2672

Qytetarja ju drejtua platformës më datë 29.10.2017 dhe mori zgjidhje me datë 10.11.2017

Problemi: Znj. Mema kishte aplikuar dhe shlyer të gjitha detyrimet pranë ZVRPP Fier për rivlerësim të pronës së saj që në muajin maj 2017. Ajo ishte interesuar disa herë pranë ZVRPP Fier por pa marrë asnjeherë shërbimin që i takon.

Zgjidhja: Në datën 29 tetor 2017 ajo ka shkruar në platformën e bashkëqeverisjes e cila menjëherë ka kontaktuar me ZQRPP dhe ZVRPP Fier. Në datën 10 nëntor 2017 ZVRPP Fier ka lëshuar çertifikatën e pronësisë znj. Mema.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Emri i Qytetarit: Sofia Çina

Nr. i çështjes: 3411

Qytetarja ju drejtua platformës më datë 13.11.2017 dhe mori zgjidhje me datë 14.11.2017.

Problemi: Sofia Çina, 26 vjeç nga Korca, ka përfunduar studimet në degën Mjekësi e Përgjithshme. Në shtator 2017 emërohet nga Drejtoria e Shëndetit Publik Korçë si mjeke familje ku vihet në dijeni se për të filluar punë duhej një kërkesë për aprovim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Zonja kishte dërguar kërkesën për aprovim pranë MSHMS dhe kishte rreth dy muaj që priste një përgjigje.

Zgjidhja: Sofia iu drejtua platformës ëëë.shqipëriaqëduam.al për një zgjidhje të problemit të saj në datën 13.11.2017 dhe në datën 14.11.2017, siguroi miratimin e kërkesës për emërim të saj pranë QSH 1 Korçë si mjeke.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Emri i Qytetarit: Idlir Ismailaj

Nr. i çështjes: 2656

Qytetari ju drejtua platformës më datë 29.10.2017 dhe mori zgjidhje me datë 21.11.2017.

Problemi: Qytetari ishte dy vjet që kërkonte një vërtetim për konvertimit e lejes së drejtimit të automjetit nga italiane në shqiptare.
Zgjidhja: Pas paraqitjes së rastit të tij në Platformë Z. Ismailaj u kontaktua menjëherë nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore në MEPJ dhe u informua në mënyrë të detajuar për procedurën e lëshimit të këtij dokumenti. Më pas ai u prit personalisht në MEPJ ku përfundoi të gjithë procedurën.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Emri i qytetarit: Gjovalin Veshtaj

Nr. Çështjes: 2956

Qytetari ju drejtua platformës më datë 07.11.2017 dhe mori zgjidhje me datë 17.11.2017.

Problemi: Z.Gjovalin Veshtaj nga Kastrati, Malësi e Madhe, anëtar i PD që 1992, ka aplikuar në portalin 'Mësues për Shqiperinë' në 2014 dhe në 2017 ka dalë i pari në testin për degën Gjeografi. Qytetari u ankua në platformë pasi konstatoi që ishte punësuar padrejtësisht i dyti në testin e organizuar.

Zgjidhja: Sipas rastit të paraqitur në platformë, Z. Veshtaj u thirr në Zyrën Arsimore të Malësisë së Madhe në datën 17 nëntor 2017 dhe iu propozua detyra në dy shkolla 9 vjeçare, Kamicë dhe Bajzë. Z. Veshtaj zgjodhi me shumë dëshirë t'i bashkohet shkollës 9 vjeçare të Bajzës.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Emri i Qytetarit: Mikel Stena

Nr. i çështjes: 3659

Qytetari ju drejtua platformës më datë 15.11.2017 dhe mori zgjidhje me datë 20.11.2017.

Problemi: Z. Stena ankohej për një mbi faturim me rreth 9000 kë për faturën e energjisë të muajit Qershor 2016. Megjithëse ishte konstatuar mbi faturimi nga grupi i punës, akoma nuk ishte marrë asnjë masë për anulimin e kësaj fature.
Zgjidhja: Pas paraqitjes së rastit të tij në Platformë zyra e OSHEE kreu verifikimet e nevojshme dhe ndërmori rregullimet e duhura duke zgjidhur rastin dhe korrigjuar mbi faturimin.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Emri i Qytetarit: Thoma Duka

Nr. i çështjes: 3642

Qytetari ju drejtua platformës më datë 15.11.2017 dhe mori zgjidhje me datë 16.11.2017.

Problemi: Z. Dhuka, i cili jeton në Greqi, ankohej për gabime në faturën e energjisë elektrike të prindërve të tij pensionistë. Faturisti në vend që të shënonte harxhimin mujor 200 KW, e kishte shënuar 2000 KW.

Zgjidhja: Pas kontaktimit të koordinatorëve të Zyrës së Bashkëqeverisjes me OSHEE, problemi i mbifaturimit u zgjidh.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Emri i qytetarit: Resmi Tallas

Nr. Çështjes: 3306

Qytetarja ju drejtua platformës në datë 11.11.2017 dhe mori zgjidhje në datë 15.11.2017.

Problemi: Z. Tallas, i cili me profesion është mësues në shkollën e mesme profesionale "Kristo Isak" Berat, në procedurën e legalizimit të dokumentave për bursën e vajzës së tij e cila është për studime në Itali, midis të tjerash kërkon një vërtetim page, vërtetim i cili dikur bëhej në Ministrinë e Mirëqënies dhe Punëve Sociale, ndërsa tani në MFE. Kur u paraqit në MFE, nuk mundi të gjejë zgjidhje për problemin e tij, duke rrezikuar të tejkalohej afati i përgatitjes së dokumentave për vajzën e tij dhe ajo të humbiste bursën.

Zgjidhja: Rasti i prezantuar në platformë nga qytetari, u ndoq me shumë prioritet pasi afati i aplikimit për bursë ishte data 17 nëntor dhe qytetari u njoftua menjëherë të paraqitej pranë zyrës së protokollit të ministrisë dhe të merte dokumentin e kërkuar. Dokumenti u lëvrua në datën 15 nëntor 2017.

HISTORI SUKSESI

- **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Emri i qytetarit: Meme Dalipaj

Nr. çështjes 3774

Qytetarja ju drejtua platformës në datë 16.11.2017 dhe mori zgjidhje në datë 22.11.2017.

Problemi: ISSH e Vlorës nuk i lidhte pensionin qytetares për arsye të disa pasaktësive në emrin e të atit të saj.

Zgjidhja: MFE shqyrtoi rastin duke caktuar përfitimin e pensionit.

▶AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

http://www.shqiperiaqeduam.al/